



Shqipëria ngjitet në 2% të Mbrojtjes: Rama dhe Rutte konfirmojnë aleancën e fortë me NATO-n



» faqe 3



KARTA E ADRIATIKUT: SHQIPËRIA RRIT ROLIN E SAJ STRATEGJIK NË SIGURINË EUROATLANTIKE

Në Konferencën e 28-të të Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të Kartës së Adriatikut (SHBA-A5), zhvilluar në Tiranë, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu theksoi angazhimin e Shqipërisë për forcimin e sigurisë rajonale dhe pozicionimin e vendit si një qendër të besueshme për industrinë... » faqe 2



SHSHPPFA, GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI: UNITETI, GARANCIA MË E FORTË PËR PAQE E STABILITET NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Në Tiranë u zhvillua Konferenca e 28-të e Shefave të Shtabit të Forcave të Armatosura të nismës SHBA-Karta e Adriatikut (A-5), një forum i rëndësishëm për sigurinë rajonale. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, në fjalën... » faqe 4



NGA KUFIJTË E BALLKANIT NË QENDËR TË NATO-S: SAMITI 2027, SFIDA DHE SHANSI HISTORIK I SHQIPËRISË

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në vitin 2027, Shqipëria do të hyjë në historinë e saj moderne, duke pritur Samitin e Aleancës më të fuqishme ushtarake dhe politike në botë - NATO-s. Ky zhvillim shënon një moment kulmor për një vend të vogël ballkanik që... » faqe 6

Karta e Adriatikut: Shqipëria rrit rolin e saj strategjik në sigurinë euroatlantike

Në Konferencën e 28-të të Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të Kartës së Adriatikut (SHBA-A5), zhvilluar në Tiranë, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu theksoi angazhimin e Shqipërisë për forcimin e sigurisë rajonale dhe pozicionimin e vendit si një qendër të besueshme për industrinë e mbrojtjes.

Ministri Vengu nënvizoi se Shqipëria po investon në ngritjen e një infrastrukture ushtarake që i përgjigjet standardeve të NATO-s.

Ai theksoi rëndësinë e rritjes së burimeve financiare për buxhetet e mbrojtjes dhe zgjerimin e industrisë së mbrojtjes dhe prodhimit ushtarak si hapa të domosdoshëm për modernizimin e Forcave të Armatosura.

Një nga objektivat kryesore të Shqipërisë, sipas Ministrit Vengu, është pozicionimi i vendit si një qendër e besueshme për industrinë e mbrojtjes. Gjithashtu, ai theksoi rëndësinë e lidhshmërisë dhe ndërveprimit ushtarak në rajonin e Adriatikut dhe Evropën Juglindore si pjesë e strategjisë për forcimin e sigurisë euro-atlantike.

“Karta e Adriatikut lindi si vizion i bashkëpunimit dhe stabilitetit euroatlantik. Në një mjedis strategjik që ndryshon me shpejtësi, ne duhet të përshtatemi dhe të ripërtërijmë misionin e saj”, - u shpreh Vengu, duke nënvizuar se pjesëmarrja e Shteteve të Bashkuara e bën këtë nismë të pazëvendësueshme për sigurinë rajonale.

Më tej ministri i Mbrojtjes Vengu parashtroi pesë prioritetet kryesore të Shqipërisë për forcimin e mbrojtjes.

- Rritja e buxhetit të mbrojtjes
- Zgjerimi i industrisë së mbrojtjes dhe prodhimit ushtarak
- Modernizimi i Forcave të Armatosura me aftësi vdekjeprurëse dhe përdorim të dyfishtë
- Investimi në infrastrukturën kritike dhe kapacitetet pritëse
- Forcimi i ndërveprimit me aleatët përmes stërvitjeve dhe operacioneve të përbashkëta

“Shqipëria mbetet e angazhuar në misionet ndërkombëtare të NATO-s dhe BE-së, duke kontribuar me rreth 500 trupa në misionet e KFOR-it, ALTEA-s dhe në Letoni dhe Bullgari. Ky angazhim është një shenjë e përkushtimit të Shqipërisë për



stabilitetin dhe sigurinë rajonale.

Kosova duhet të përfshihet plotësisht dhe formalisht si anëtare e natyrshme e Kartës së Adriatikut, përfshirja e Kosovës është e rëndësishme për forcimin e bashkëpunimit dhe stabilitetit rajonal. Qëllimi ynë është ta pozicionojmë Shqipërinë si një qendër të besueshme për industrinë e mbrojtjes, një nyje kyçe të lëvizshmërisë dhe bashkëpunimit ushtarak në Adriatik dhe në të gjithë Evropën Juglindore”, - mbylli fjalën e tij ministri Vengu.

Shqipëria ngjitet në 2% të Mbrojtjes: Rama dhe Rutte konfirmojnë aleancën e fortë me NATO-n

Rama takon në Bruksel Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte: Shqipëria arrin objektivin 2% dhe synon ndërtimin e portit të ri ushtarak në Porto Romano

Kryeministri Edi Rama zhvilloi një takim zyrtar në Bruksel me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte, në selinë e Aleancës së Atlantikut të Veriut. Diskutimet u përqendruan te roli i Shqipërisë në NATO, kontributi ndaj sigurisë euroatlantike, ndihma për Ukrainën dhe projektet strategjike për zhvillimin e industrisë së mbrojtjes.

Sekretari i Përgjithshëm Rutte vlerësoi lart angazhimin e Shqipërisë si një partner i fortë i NATO-s, duke theksuar se vendi ynë këtë vit do të arrijë objektivin e 2% të shpenzimeve për mbrojtjen, një standard i vendosur nga Aleanca. Ai theksoi gjithashtu se Shqipëria ka luajtur një rol aktiv përtej madhësisë së saj si shtet, si brenda vendit ashtu edhe jashtë kufijve.

“Është një nder i madh të kem këtu mikun tim të ngushtë, Edi Ramën, Kryeministrin e Shqipërisë. Shqipëria është një aleat i fortë. Shqipëria këtë vit do të arrijë nivelin 2% të shpenzimeve për mbrojtjen, që është një angazhim i madh. Ju po bëni shumë sa i përket ndihmës për Ukrainën dhe jeni aktivë në Letoni, Bullgari e Kosovë. Shqipëria nuk është aleati më i madh, por po jep një kontribut shumë më të madh se sa madhësia e saj. Ne e dimë që NATO mund të mbështetet gjithmonë te Shqipëria”, - u shpreh Rutte.

Ai nënvizoi gjithashtu rëndësinë e zhvillimit të industrisë së mbrojtjes në Shqipëri, duke përmendur ndërmarrjen shtetërore dhe projektet që synojnë krijimin e një baze më të fortë industriale në kuadër të Aleancës. Sipas tij, ky zhvillim është jetik për sigurinë e përbashkët dhe për mbështetjen që NATO i jep Ukrainës.

Nga ana e tij, Kryeministri Rama falënderoi për mikpritjen dhe vlerësimin, duke riafirmuar vendosmërinë e Shqipërisë për të thelluar kontributin e saj në sigurinë kolektive.

“Është gjithmonë kënaqësi të jemi këtu, jo vetëm për shkak të miqësisë sonë të gjatë, por sepse gjithmonë ka diçka për të mësuar. Ne jemi këtu për të rikonfirmuar gjithçka që u tha dhe për të bërë më shumë. Shqipëria po hedh bazat për rilindjen e industrisë sonë ushtarake dhe synon të japë një kontribut më të madh në NATO”, - deklaroi Rama.

Kreu i qeverisë ndaloi veçanërisht te një nga projektet më strategjike që Shqipëria synon të realizojë në partneritet me Aleancën: ndërtimi i një porti të ri ushtarak në Porto Romano. Ai e cilësoi këtë si një hap të rëndësishëm për rritjen e kapaciteteve ushtarake të vendit dhe për sigurinë rajonale.

“Jemi shumë të interesuar të diskutojmë me ju hapat e mëtejshëm për ndërtimin e portit të ri ushtarak në Porto Romano. Gjithashtu, duam të shqyrtojmë mundësinë e përfshirjes në programin ‘Safe’ të Bashkimit Evropian, i cili mund të jetë i dobishëm edhe për vendet e NATO-s”, - theksoi Rama.

Takimi u mbyll me konfirmimin e dyanshëm se Shqipëria mbetet një partner i besueshëm dhe i angazhuar në kuadër të Aleancës,



ndërsa NATO garanton mbështetje të plotë për vendin tonë.

Vizita e Kryeministrit Rama në Bruksel ishte dyditore dhe u shoqërua me një tjetër

zhvillim të rëndësishëm për procesin e integritit evropian. Të mërkurën, Shqipëria mori zyrtarisht “dritën jeshile” për hapjen e grup-kapitullit të pestë në negociatat

me BE-në, atë të “Axhendës së Gjelbër dhe Ndërlidhjes së qëndrueshme”, duke shënuar pesë nga gjashtë grup-kapitujt e hapur brenda vetëm 11 muajve.



SHSHHPFA, gjenerallejtënant Arben Kingji: Uniteti, garancia më e fortë për paqe e stabilitet në Ballkanin Perëndimor

Në Tiranë u zhvillua Konferenca e 28-të e Shefave të Shtabit të Forcave të Armatosura të nismës SHBA-Karta e Adriatikut (A-5), një forum i rëndësishëm për sigurinë rajonale.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, në fjalën e tij theksoi rëndësinë e këtij bashkëpunimi shumëpalësh, duke vënë në dukje se uniteti është çelësi i paqes dhe stabilitetit në rajonin tonë.

“Jam i nderuar që bashkë-kryesova këtë konferencë me komandantin e Komandës Amerikane për Evropën dhe Komandës Supreme Aleate, gjeneral Alexis Grynkeuich, dhe me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Bosnjë-Hercegovinës, gjeneral Gojko Knežević”, – u shpreh gjenerallejtënant Kingji.

Ai nënvizoi se Karta e Adriatikut mbetet një instrument i veçantë për forcimin e marrëdhënieve mes vendeve të rajonit, sidomos në kushtet aktuale kur sfidat e sigurisë janë në rritje.

“Kjo nismë mbetet një platformë e veçantë për forcimin e bashkëpunimit rajonal, në këtë kohë sfidash të sigurisë, ku uniteti ynë është garancia më e fortë për paqe dhe stabilitet në Ballkanin Perëndimor”, – deklaroi ai.

Në vijim, shefi i Shtabit të Përgjithshëm siguroi përfaqësuesit e vendeve pjesëmarrëse se Shqipëria është dhe do të mbetet e angazhuar në objektivat e përbashkëta të kësaj nisme.



“Shqipëria mbetet plotësisht e angazhuar ndaj objektivave të Kartës së Adriatikut, duke punuar krah për krah me aleatët dhe partnerët tanë për një të ardhme më të sigurt dhe më të begatë për popujt tanë”, – theksoi gjenerallejtënant Kingji.

Konferenca e Kartës së Adriatikut shërben si një mekanizëm bashkëpunimi dhe koordinimi mes vendeve të rajonit dhe Shteteve të Bashkuara, me synim forcimin e sigurisë dhe stabilitetit në Evropën Juglindore.

Ndërsa në fjalën e tij të rastit Komandanti i Komandës Europiane të Shteteve të Bashkuara (EUCOM) dhe Komandant Suprem i Forcave Aleate për Evropën (SACEUR), gjeneral Grynkeuich vlerësoi udhëheqjen e vendeve të rajonit dhe riafirmoi mbështetjen e SHBA-së për sigurinë dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor dhe mirënjohje për mikpritjen dhe udhëheqjen rajonale.



Gjenerali Grynkeuich falënderoi Shqipërinë dhe Bosnjë-Hercegovinën për mikpritjen dhe kontributin e tyre në organizimin e aktivitetit.

“Një qytet shumë i bukur! Vendet tuaja kanë treguar udhëheqje të vërtetë dhe një angazhim të jashtëzakonshëm për sigurinë dhe stabilitetin nga të cilët të gjithë ne përfitojmë”, – u shpreh ai.

Në fjalën e tij, gjenerali Grynkeuich theksoi rolin e



pazëvendësueshëm të Kartës së Adriatikut si platformë për dialog strategjik dhe bashkëpunim praktik midis vendeve anëtare: Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Kroacisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut si dhe dy vendeve vëzhguese, Kosovës dhe Sllovenisë.

“Është thelbësore që të takohemi rregullisht për të forcuar bashkëpunimin tonë. SHBA-Karta e Adriatikut mbetet një forum i pazëvendësueshëm për një Europë të lirë, të sigurt dhe të begatë”, – theksoi ai.

Gjenerali kujtoi nënshkrimin e Deklaratës së Përbashkët, duke e cilësuar si një akt që riafirmoi vizionin e përbashkët për stabilitetin dhe sigurinë euro-atlantike: “Ishte një nder të përfaqësoja Shtetet e Bashkuara në këtë nënshkrim që thekson rëndësinë e koordinimit të ngushtë për sigurinë rajonale”.

Në mesazhin e tij, Komandanti i NATO-s për Evropën theksoi nevojën që rritja e shpenzimeve për mbrojtjen të shndërrohet në aftësi të prekshme ushtarake përmes modernizimit dhe bashkëpunimit të ngushtë.

“Duhet të përqendrohemi në përmirësimin e ndërveprueshmërisë, ndërtimin e gatishmërisë dhe zhvillimin e marrëveshjeve mbështetëse. Pas diskutimeve optimiste të sotme, jam i bindur se mund t’i arrijmë këto qëllime.”

Gjenerali Grynkeuich vlerësoi programin e punës së grupit të implementimit për vitin e ardhshëm dhe u shpreh i bindur se sfidat mund të përballohen përmes solidaritetit.

“Teksa ecni përpara, dini se nuk jeni vetëm. Së bashku me kolegët dhe aleatët e Kartës së Adriatikut, ne do të përqafojmë një të ardhme të sigurt, të qëndrueshme dhe të begatë”.

Shqipëria mirëpret Komandantin Suprem të NATO-s: Partneritet i pathyeshëm me SHBA-në për sigurinë rajonale

Në Tiranë u zhvillua një vizitë e nivelit më të lartë ushtarak e diplomatik, ku Gjeneral Alexis Gregory Grynkeuich, Komandant i Komandës Europiane të Shteteve të Bashkuara (EUCOM) dhe Komandant Suprem i Forcave Aleate për Europën (SACEUR), u prit nga Presidenti Bajram Begaj, Kryeministri Edi Rama, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralletënant Arben Kingji.

Vizita, e parë e Grynkeuich në Shqipëri, u zhvillua në kuadër të Konferencës së 28-të të Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të Kartës së Adriatikut (SHBA-A5), e cila u mbajt në Tiranë.



Presidenti Begaj: SHBA, garancia e sigurisë sonë

Presidenti i Republikës Bajram Begaj theksoi se prania e SHBA-ve në Ballkanin Perëndimor është e pazëvendësueshme për paqen dhe stabilitetin.

“Shqipëria vlerëson fort mbështetjen amerikane dhe rolin udhëheqës të Shteteve të Bashkuara në Aleancë. Partneriteti ynë është më i fortë se kurrë dhe do të vijojë të konsolidohet në çdo fushë të mbrojtjes dhe sigurisë”, – u shpreh Presidenti Begaj.



Kryeministri Rama: Bashkëpunim strategjik dhe i qëndrueshëm

Kryeministri Edi Rama nënvizoi se Shqipëria mbetet një aleat i palëkundur i SHBA-ve dhe NATO-s.

“Ne ndajmë të njëjtat shqetësime mbi sfidat e sigurisë në Europën Juglindore dhe jemi të vendosur të rrisim investimet në mbrojtje, në përputhje me angazhimet tona në Samitin e Hagës. Ky është një investim i drejtpërdrejtë për të ardhmen tonë të përbashkët si pjesë e Aleancës”, – theksoi Kryeministri.

Ministri Vengu: Inovacion për një ushtri moderne

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, vuri në dukje se Shqipëria po ndërmerr hapa të vendosur për modernizimin e ushtrisë, duke vendosur inovacionin në qendër të industrisë



dhe infrastrukturës së mbrojtjes.

“Jemi duke punuar për të rritur kapacitetet tona reaguese dhe për të mbështetur misionet e NATO-s dhe BE-së, ku trupat shqiptare janë tashmë të angazhuara, sidomos në KFOR”, – theksoi Vengu.

Gjeneralletënant Kingji: Uniteti, garanci për paqen

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralletënant Arben Kingji, i cili bashkë-kryesoi Konferencën së bashku me gjeneralin Grynkeuich dhe gjeneralin e Bosnjës, Gojko Knežević, theksoi rëndësinë e unitetit rajonal dhe koordinimit të ngushtë ushtarak.

“Kjo nismë mbetet një platformë e veçantë për forcimin e bashkëpunimit rajonal, në këtë kohë sfidash të sigurisë, ku uniteti ynë është garancia më e fortë për paqe dhe stabilitet në Ballkanin Perëndimor”, – u shpreh Kingji.

Ai shtoi se Shqipëria mbetet e angazhuar krah aleatëve dhe partnerëve të saj, për të ndërtuar një të ardhme të sigurt dhe të begatë për popujt e rajonit.

Nga ana e tij, gjenerali Grynkeuich vlerësoi angazhimin e Shqipërisë dhe të vendeve të Kartës së Adriatikut për ndarjen e përgjegjësi në fushën e sigurisë.

“Jam optimist për angazhimin rajonal në forcimin e bashkëpunimit dhe stabilitetit. Së bashku, ne mund të ndërtojmë një Europë Juglindore më të sigurt dhe më të qëndrueshme”, – deklaroi ai. Vizita e Komandantit Suprem të NATO-s në Europë shënon një moment të rëndësishëm në marrëdhëniet dypalëshe Shqipëri-SHBA dhe në konsolidimin e bashkëpunimit transatlantik, duke riafirmuar rolin strategjik të vendit tonë në Aleancën e Atlantikut të Veriut.



Shqipëria dhe Bullgaria, krah për krah për sigurinë europiane

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu priti në Tiranë zëvendësministrin e Mbrojtjes të Bullgarisë, Atanas Zapryanov, në vizitën e tij të parë zyrtare në vendin tonë.

Gjatë takimit, të dyja palët nënvizuan rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit mes dy vendeve aleate, si në planin dypalësh ashtu edhe në kuadër të NATO-s. Ministri Vengu vlerësoi partneritetin e qëndrueshëm me Bullgarinë, duke theksuar se të dy vendet ndajnë të njëjtat shqetësime për sfidat e sigurisë në Europën Juglindore.

“Me Bullgarinë ndajmë vlerësime të njëmendta mbi rreziqet dhe sfidat në Europën Juglindore, si dhe mbi rëndësinë e konkretizimit të investimeve strategjike në industri dhe infrastrukturë, siç janë Korridori VIII dhe Porto Romano, për lëvizshmërinë e forcave aleate në rajon”, – deklaroi ministri Vengu.

Palët u ndalën edhe në misionet e përbashkëta, ku trupat shqiptare dhe



bullgare shërbejnë sot. “Shqipëria dhe Bullgaria do të vijojnë të qëndrojnë krah për krah në mbështetje të sigurisë europiane, siç bëjmë aktualisht në Forcën e Përparuar të NATO-s në Bullgari, si dhe në misionin KFOR në Kosovë”, – shtoi Vengu.

Vizita e z. Zapryanov shënon një hap të ri në forcimin e partneritetit strategjik mes dy vendeve, duke e pozicionuar Shqipërinë dhe Bullgarinë si faktorë të rëndësishëm për paqen dhe stabilitetin në rajon dhe përtej tij.



Forcat e Armatosura dhe Garda Kombëtare e Nju Xhersit, partneritet i qëndrueshëm në rritje

Shefi i shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralletënant Arben Kingji, priti në një takim pune komandanten e Gardës Kombëtare të Nju Xhersit, gjeneral brigade Yvonne Mays, me të cilën u diskutua mbi thellimin e bashkëpunimit në kuadër të Programit të Partneritetit Shtetëror.

Bashkëbisedimi u fokusua në zgjerimin e aktiviteteve të përbashkëta, me synim forcimin e kapaciteteve, profesionalizmit dhe ndërveprimit mes forcave të të dyja vendeve.

“Ky partneritet i qëndrueshëm mbetet një garanci e fortë për përgatitjen dhe aftësimin e mëtejshëm të Forcave të Armatosura”, – u shpreh gjeneralletënant Kingji, duke nënvizuar rolin e rëndësishëm që ky bashkëpunim ka pasur ndër vite në ngritjen e standardeve të ushtrisë shqiptare.



Takimi shënoi një tjetër hap përpara në marrëdhëniet e konsoliduara mes Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe Gardës Kombëtare të Nju Xhersit, duke hapur rrugën për projekte të reja trajnimi dhe bashkëpunimi të ndërsjellë.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në vitin 2027, Shqipëria do të hyjë në historinë e saj moderne, duke pritur Samitin e Aleancës më të fuqishme ushtarake dhe politike në botë - NATO-s. Ky zhvillim shënon një moment kulmor për një vend të vogël ballkanik që, vetëm pak dekada më parë ishte i izoluar, me një ushtri ku kapacitetet logjistike dhe burimet njerëzore linin për të dëshiruar dhe pa lidhje me strukturat euroatlantike.

Sot, pas më shumë se 18 vjetësh anëtarësim në NATO, Shqipëria bëhet epiqendër e një prej takimeve më të rëndësishme të sigurisë globale. Ky samit nuk është vetëm një ngjarje ceremoniale. Ai mbart me vete dimensione të thella politike, ekonomike, ushtarake dhe diplomatike, që do të ndikojnë si mbi vendin tonë, ashtu edhe mbi rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Prestigji ndërkombëtar: Shqipëria në qendër të hartës botërore

Pritja e një samiti të NATO-s nuk është një ngjarje rutinë. Ajo vjen vetëm për vende që kanë arritur të tregojnë besueshmëri politike, stabilitet diplomatik dhe një rol të qartë në strukturat e aleancës. Për Shqipërinë, kjo do të thotë ngritje e profilin ndërkombëtar dhe një mesazh i fuqishëm për partnerët strategjikë, se vendi ynë është një aktor serioz në arkitekturën e sigurisë euroatlantike.

Ky prestigj nuk përkthehet vetëm në fjalë. Ai krijon hapësira për rritje të besueshmërisë diplomatike, forcim të marrëdhënieve bilaterale me SHBA-në, BE-në dhe aleatët kryesorë të NATO-s, si dhe shndërron Shqipërinë në një pikë referimi për politikën e sigurisë në rajon.

Dimensioni ekonomik: Nga infrastruktura tek turizmi

Samiti i NATO-s do të jetë një provë gjigante për kapacitetet logjistike dhe ekonomike të vendit. Aeroportet, rrugët, hotelet, qendrat e konferencave dhe infrastruktura e sigurisë duhet të modernizohen dhe të përshtaten për të pritur qindra delegacione, media ndërkombëtare dhe mijëra pjesëmarrës.

Ky proces sjell përfitime të dyfishta:

- Afatshkurtër, do të krijojë punësim, kontrata dhe qarkullim ekonomik për sektorin privat (ndërtim, hotelieri, transport, teknologji).

- Afatgjatë, investimet në infrastrukturë civile e ushtarake do të mbeten trashëgimi për qytetarët, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve publike dhe duke rritur kapacitetet e pritjes për evente ndërkombëtare.

Turizmi gjithashtu përfiton. Imazhi i Shqipërisë si një vend mikpritës, i sigurt dhe i integruar në strukturat euroatlantike, forcon brandin e vendit në tregun global.

Dimensioni ushtarak: Modernizim dhe përgjegjësi të reja
Samiti i Hagës 2025 ka vendosur objektiva të rinj për NATO-n: shtetet anëtare duhet të rrisin shpenzimet ushtarake në 5% të PBB-së deri në vitin 2035. Për Shqipërinë, kjo do të thotë një transformim rrënjësor të politikave të mbrojtjes.

Kjo nënkupton:

- Investime në bazat ushtarake si ajo e Kuçovës, e cila tashmë është shndërruar në një qendër moderne për operacione ajrore të NATO-s.

- Modernizim të pajisjeve: mjete të blinduara, sisteme mbrojtjeje ajrore, dronë dhe teknologji të reja komunikimi.

- Rritje të trajnimit dhe stërvitjeve: Shqipëria mund të



Nga kufijtë e Ballkanit në qendër të NATO-s: Samiti 2027, sfida dhe shansi historik i Shqipërisë

shndërrohet në një arenë rajonale për stërvitje të përbashkëta të aleatëve, duke forcuar ndërveprimin e forcave tona me partnerët.

- Siguri kibernetike: një front i ri ku NATO investon fuqishëm dhe ku Shqipëria duhet të rrisë kapacitetet.

Impakti rajonal: Shqipëria si lider në Ballkan

Pritja e Samitit e vendos Shqipërinë në një rol të ri në Ballkan. Vendi bëhet jo vetëm mikpritës i një ngjarjeje të madhe, por edhe një qendër graviteti për sigurinë rajonale.

Për fqinjët që janë jashtë NATO-s, si Serbia, kjo është një shenjë e qartë e thellimit të pranisë perëndimore në rajon.

Për Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Kosovën (partner i afërt i NATO-s), është një mundësi për të forcuar bashkëpunimin rajonal të sigurisë.

Për Bashkimin European, kjo e kthen Shqipërinë në një partner më të besueshëm për integrimin dhe për projektet e mbrojtjes së përbashkët.

Një mundësi që nuk duhet humbur

Samiti i NATO-s në Shqipëri është një shans i artë për vendin tonë. Ai mund të jetë një pikë kthese për modernizimin e ushtrisë, forcimin e infrastrukturës, rritjen e prestigjit ndërkombëtar dhe fuqizimin e rolit rajonal. Por kjo varet nga mënyra si Shqipëria do ta menaxhojë këtë sfidë: me vizion, me transparencë dhe me angazhim maksimal. Nëse këto kushte plotësohen, viti 2027 do të mbahet mend jo vetëm si viti kur Shqipëria priti liderët botërorë, por edhe si viti kur vendi bëri hapin më të madh drejt konsolidimit të tij si një aktor i peshës në sigurinë euroatlantike.

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Më edukoni, mos më poshtëroni!

Një reflektim për fuqinë e gabimit dhe nevojën për një kulturë të re në shoqërinë shqiptare. Në çdo hap të jetës sonë, qoftë në bankat e shkollës, në vendin e punës apo në marrëdhëniet personale, gabimi është i pashmangshëm. Por ajo që ka rëndësi nuk është nëse gabojmë apo jo, por si reagojmë ndaj gabimeve dhe, më e rëndësishmja, si i trajton shoqëria ato.

Edukimi pa poshtërim, filozofia që mungon

Në vend që gabimi të shihet si një mjet për të nxitur përmirësimin, në shumë raste në shoqërinë shqiptare ai ende konsiderohet si shenjë paaftësie apo dështimi. Kjo sjell pasiguri, frikë dhe mbyllje të individit. Në klasë, një nxënës që gabon rrallë nxitet të provojë sërish, në punë, një gabim shpesh i kushton reputacionin punonjësit. Kjo logjikë e ngurtë i largon njerëzit nga rritja personale dhe nga ndarja e lirë e ideve. Në të kundërt, trajtimi me respekt dhe qasja që e sheh gabimin si pjesë të mësimin, nxisin besimin, kurajën dhe përmirësimin. Shoqëritë që përqafojnë këtë filozofi zhvillojnë individë më të guximshëm, më krijues dhe më të përgjegjshëm.

Shoqëria shqiptare përballë kësaj filozofie

Në Shqipëri, kultura e turpit dhe e “mos gabimit” ka qenë për dekada një pengesë për zhvillimin e lirë të mendimit dhe shprehjes. Gabimi shihej shpesh si arsye për ndëshkim apo turpërim në familje, në shkollë apo në ambientin profesional. Ky lloj trajtimi e ka bërë të vështirë ndërtimin e një shoqërie ku njerëzit ndihen të lirë të mësojnë nga përvojat e tyre.

Megjithatë, ndryshimet janë të dukshme. Brezat e rinj, të ekspozuar ndaj ideve moderne dhe përvojave ndërkombëtare, po sjellin një frymë të re, më shumë vetëdije, më shumë tolerancë ndaj gabimeve dhe më shumë hapësirë për dialog.

Por ky ndryshim nuk është i lehtë. Ende ka shumë mjedise arsimore dhe institucionale ku gabimi përdoret për të ulur moralin, për të ruajtur autoritetin apo për të ndaluar zërat ndryshe. Prandaj ndryshimi duhet të vijë nga të gjithë ne, nga prindërit, mësuesit, drejtuesit, e deri te vetë fëmijët që kërkojnë të mësojnë pa frikë.

Rruga përpara, një shoqëri që pranon të mësojë

Të edukosh dikë nuk do të thotë ta bësh të ndihet më pak. Do të thotë ta ngresh me dije, me durim dhe me dashuri.

Shoqëria jonë ka nevojë më shumë se kurrë për këtë qasje, një kulturë ku pyetja, mendimi ndryshe dhe gabimi të mos trajtohen si dobësi, por si shenja të guximit për të mësuar.

Le të mos kemi frikë nga gabimi. Le të kemi frikë nga mungesa e guximit për të përmirësuar njëri-tjetrin. Le të zgjedhim të edukojmë me respekt dhe jo të poshtërojmë me arrogancë.

Nga frika e gabimit tek guximi për të mësuar

Edukimi shpesh ngatërrohet me disiplinim dhe turpërim. Shumë nxënës e mbajnë mend klasën jo si vend të dijes, por si skenë ku gabimi ndëshkohet. Ende dëgjojmë raste ku mësuesi e ul nxënësin para gjithë klasës: “Ti nuk di asgjë!”. Edhe në universitet, studentët shpesh nuk guxojnë të bëjnë pyetje, nga frika se do të etiketohen si “të dobët”. Kjo kulturë nuk

“Nëse jam gabim më edukoni, mos më poshtëroni”



edukon, por ngurtëson dhe shkurajon. Në punë, ide të reja shpesh priten me skepticizëm dhe jo me kuriozitet. Një punonjës që gabon një herë, në vend që të trajtohet si dikush që po mëson, mbetet me “etiketën” e gabimit të parë. Në politikë dhe në hapësirën publike, mendimi ndryshe shihet si rrezik, jo si pasuri. Kjo klimë përforcon frikën nga gabimi dhe i shtyn njerëzit drejt heshtjes e konformizmit.

Por a është ky edukim? Sigurisht që jo. Edukimi i vërtetë është të ngresh dikë me dije dhe me respekt. Një mësues që i thotë nxënësit: “E gabuat, por të provojmë sërish bashkë” krijon më shumë motivim sesa ai që e poshtëron.

Një prind që e mëson fëmijën se gabimi është hap drejt përmirësimit, rrit një individ të lirë dhe të sigurt. Një drejtues që dëgjon ide të ndryshme, krijon besim

dhe hapësirë për zhvillim.

Shoqëria jonë ka nevojë për një kthesë të madhe kulturore. Pyetja nuk është sfidë ndaj autoritetit, por shenjë kurioziteti. Mendimi ndryshe nuk është kërcënim, por mundësi për të parë më larg. Gabimi nuk është turp, por mjet i domosdoshëm për të mësuar.

Nëse nuk dalim nga ky mentalitet poshtërues, do të prodhojmë breza që heshtin dhe përshtaten, jo qytetarë që guxojnë të krijojnë e të ndërtojnë. Por nëse zgjedhim respektin mbi arrogancën, durimin mbi përçmimin, do të ngremë një shoqëri më të fortë, më të lirë dhe më të drejtë.

Edukimi i vërtetë nuk poshtëron. Edukimi i vërtetë ngre. Dhe shoqëria jonë nuk ka nevojë për më shumë frikë nga gabimi, por për më shumë guxim për të mësuar së bashku.

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Barazia që vonon: Gruaja shqiptare në betejë me stereotipat



‘Gjysma e shoqërisë që nuk pranon më të heshtë’ Historia e shoqërisë shqiptare është një histori e ndërtuar mbi kontradikta të mëdha: nga njëra anë, një traditë e gjatë e shoqërisë patriarkale, ku figura e burrit ka mbizotëruar në sferën publike dhe vendimmarrëse; nga ana tjetër, qëndresa e gruas, e cila ka mbajtur mbi supet e saj barrën e familjes, të moralit dhe shpeshherë edhe të vetë mbijetesës së kombit. Sot, në një kohë tranzicioni të gjatë kulturor e shoqëror, gruaja shqiptare përballet ende me “unin maskilist”, një strukturë të ngulitur thellë në mentalitet, në raportet shoqërore, madje edhe në vetë institucionet.

Dimensioni historik: femra mes nënshtrimit dhe qëndresës

Në traditën shqiptare, e mishëruar për shekuj në Kanunin e Lekë Dukagjinit dhe rregullat e zakonshme të jetës fshatare e qytetare, gruaja është parë shpesh si “pjesë e shtëpisë”, e kufizuar në rolin e nënës, amvisës dhe kujdestares. Burrëria, nderi dhe vendimmarrja i takonin burrit. Në shumë raste, gruaja nuk kishte të drejtë të trashëgonte, të fliste në kuvend apo të merrte pjesë në jetën publike.

Megjithatë, ky rrëfim historik nuk është i plotë pa theksuar rolin e grave që e thyen heshtjen.

Nga heroinat e historisë, si Nora e Kelmendit apo Shotë Galica, te nënat e varfra që rritën fëmijë në kushte të pamundura, gruaja shqiptare ka dëshmuar se përtej kufizimeve patriarkale, ajo ka qenë një faktor vendimtar në mbijetesën dhe formësimin e identitetit tonë kolektiv.

Uni maskilist si strukturë kulturore dhe psikologjike

“Uni” maskilist nuk është vetëm një qëndrim individual, por një ndërtim kulturor që shfaqet në shumë nivele: Në gjuhë dhe komunikim: fraza të zakonshme si “burrat janë kryefamiljarë”, “gratë nuk kuptojnë politikën”, ose “vajza është mysafire në shtëpinë e babait” e përforcojnë idenë e hierarkisë gjinore.

Në familje: shpesh vendimet madhore, që nga arsimimi i fëmijëve deri te menaxhimi i të ardhurave, mbeten të përqendruara tek figura mashkullore.

Në shoqëri: pjesëmarrja e grave në politikë apo ekonomi shpesh perceptohet si përjashtim, jo si normë, dhe shpeshherë paragjykohet.

Ky “un maskilist” ka rrënjë në frikën nga humbja e pushtetit: emancipimi i gruas shihet si rrezik për rolin dominues të burrit.

Në fakt, është një betejë simbolike mes së vjetrës dhe së resë, ku gruaja shihet ende si “tjetra”, jo si bashkëpjesëmarrëse e barabartë.

Gruaja në tranzicion: përballja me sfidat moderne

Në Shqipëri dhe trojet shqiptare, tranzicioni post-komunist solli liri të reja, por edhe pasiguri të thella.

Për gratë, kjo periudhë u shoqërua me: Migrimin masiv, ku shumë gra mbeten të vetme, duke mbajtur mbi vete familjen ndërsa burrat punonin jashtë.

Ekonominë e pasigurt, ku mungesa e vendeve të punës i shtyu gratë drejt tregut informal, shpesh pa siguri sociale.

Dhuna në familje: një nga plagët më të rënda të shoqërisë shqiptare, që ende sot kërkon një adresim serioz institucional. Arsimin dhe punësimin, megjithëse më shumë vajza diplomohen sot në universitete se djem, tregu i punës dhe hierarkitë institucionale nuk reflektojnë ende barazi reale.

Perspektiva sociologjike dhe feministe

Analizat feministe mbi shoqërinë shqiptare theksojnë se barazia gjinore nuk është thjesht një çështje ligjore edhe pse ligjet janë përmirësuar ndjeshëm. Ajo është një proces i gjatë ndryshimi kulturor. “Uni” maskilist shfaqet edhe në mënyra të fshehta, përmes stereotipave, përmes roleve të paracaktuara dhe përmes një shoqërie që shpesh e mat vlerën e gruas nga lidhja e saj me burrin, jo nga individi.

Në këtë kontekst, emancipimi i gruas shqiptare nuk është thjesht një betejë e saj personale, por një sfidë e gjithë shoqërisë. Pa barazi gjinore nuk mund të ketë zhvillim demokratik, nuk mund të ketë drejtësi sociale, nuk mund të ketë progres.

Gruaja si aktore e re në jetën sociale

Sot, gjithnjë e më shumë, gratë po thyjnë tabutë dhe po marrin rolin që u takon, në akademi, në media, në politikë, në biznes. Ato nuk janë më vetëm bartëse të traditës, por krijuese të së ardhmes. Një brez i ri po kërkon hapësira më të gjera, duke e parë barazinë jo si privilegj, por si të drejtë themelore.

Megjithatë, sfida mbetet e hapur, sa e gatshme është shoqëria shqiptare të heqë dorë nga “uni maskilist”? A është i gatshëm burri shqiptar të shohë në gruan jo një rivale, por një partnere të barabartë?

Statistika mbi pjesëmarrjen në politikë dhe përfaqësim gjinor

- Pas zgjedhjeve të 25 qershorit 2025, parlamenti i Shqipërisë përbëhet nga 39 deputete gra nga gjithsej 140 mandate. Kjo është rreth 27.85% përqindje dhe është numri më i lartë që prej vitit 1992, që kur vendi nisi sistemin pluralist.

- Në listat e kandidatëve për deputetë në këto zgjedhje, rreth 39.93% të kandidatëve ishin gra.

Kuotat gjinore në ligjin shqiptar për zgjedhjet përcaktojnë që të paktën 30% e kandidatëve në listat zgjedhore të jenë gra. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar që këto kuota janë në përputhje me Kushtetutën.

Statistika ekonomike dhe përfshirje në punë / sipërmarrje

- Sipas INSTAT, 31.4% e ndërmarrjeve ekonomike aktive (pa përfshirë fermerët) janë në pronësi ose drejtohen prej grave.

- Gratë janë më të përfaqësuara në sektorët e shërbimeve (ku rreth 40.9%) dhe në tregti (rreth 33.9%) ndër ndërmarrjet që drejtohen ose janë në pronësi grash. Por ato janë shumë më pak në sektorin e ndërtimit, vetëm rreth 16.1%.

- Sipas një raporti të vitit të kaluar, pjesëmarrja e grave në forcën punëtore (mosha 15-64) është afër 58.9%, krahasuar me burrat që është rreth 71.3%. Kjo tregon një hendek të vazhdueshëm midis burrave dhe grave në punësim.

Pengesat e identifikuar

Nga statistikat dhe analizat e ekspertëve, këto janë disa nga pengesat kryesore që dalin:

- Gratë shpesh kanë më pak burime për fushata elektorale, më pak kontakte e rrjete që mund t'i ndihmojnë për mbledhje fondesh.

- Stereotipa dhe mentalitete kulturore. Kërkesat shoqërore, pritshmëritë familjare, roli tradicional familjar, si dhe paragjykimet janë barrierat reale për gratë që duan të jenë në sipërfaqe publike dhe vendimmarrëse. (Këto nuk janë gjithmonë të matshme lehtë me statistika, por evidentohen nga analizat shoqërore dhe raportet e organizatave që merren me barazi gjinore.)

- Pabarazitë ekonomike. Dallimet në paga, punë informale me siguri të ulët, mungesë pensioni ose sigurime shoqërore në sektorët ku punojnë shumë gra etj. Këto kufizojnë mundësinë për të zgjedhur të jenë aktive politike, sepse shpesh përballen me nevojat më prioritare ekonomike.

Gruaja shqiptare është përballë një paradoksi të madh, nga njëra anë, ajo ka fituar hapësira të reja, arsimim dhe pjesëmarrje, nga ana tjetër, mbetet nën hijen e një kulture maskiliste që shpesh i mohon barazinë reale.

Por historia ka treguar se ajo nuk është dorëzuar asnjëherë. Përballë unit maskilist, gruaja shqiptare po ndërton dalëngadalë një “un” të ri: një identitet që përfshin të drejtën për të qenë vetvetja, për të ndërtuar dhe për të udhëhequr.

Ky proces nuk është i lehtë dhe nuk është i shpejtë. Por është i pashmangshëm. Sepse një shoqëri që mohon gjysmën e vet, mohon vetë të ardhmen.



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

“Nefes, dëshmia e gjallë e një udhëtimi bektashi”
- Rrënjët familjare dhe formimi shpirtëror

Pak ditë më parë më ra në dorë libri i shkruar nga Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Haxhi Dede Baba Edmond Brahimaj – Baba Mondit, me titull “Nefes – jeta ime”. Që nga faqet e para të librit kuptova se nuk kisha përpara thjesht një autobiografi, por një rrëfim shpirtëror, një udhëtim i brendshëm i një njeriu që ia ka kushtuar jetën besimit bektashi, traditës dhe misionit të tij hyjnor.

Baba Mondit në libër jep fytyrën e një lloj pelegrinazhi të shenjtë dhe profeci, ku sakrifica dhe vuajtja janë dritë, ku dashuria dhe begatia janë humanizëm, ku thjeshtësia dhe varfëria janë lartësim hyjnor, ku besimi e bën njeriun më të mirë dhe më vëlla me të tjerët. Jeta e Baba Mondit, e rrëfyer nga ai vetë, e shënjuar për të qenë epike, e parashkruar, nis nga familja dhe nga Bratajt në Vlorë.

Baba Mondit, siç del nga ky rrëfim, është një figurë e ndërtuar mbi dashurinë, sakrificën dhe thjeshtësinë. Ai e sheh jetën si një pelegrinazh të shenjtë, ku vuajtja është dritë, varfëria është lartësim, dashuria është humanizëm, dhe besimi e bën njeriun më të mirë e më vëlla me tjetrin.

Libri nis me kujtimet e hershme nga Bratajt i Vlorës, vendlindja e Baba Mondit. Familja, kujdesi prindëror, gjyshi, nëna Merushe dhe babai Hysen Brahimaj, i dhanë themelet e para të edukimit. Shkolla e parë, mësuesit, kujtimet e fëmijërisë, shfaqen si gurët e çmuar të dijes dhe shpirtit. Bratajt shfaqet jo vetëm si një vendlindje, por si një oaz dashurie dhe frymëzimi.


Në rrëfimin e tij, Baba Mondit nderon dy figura të ndritura të bektashizmit, dede Ahmetin dhe dede Reshatin, që luajtën rol vendimtar në formimin e tij. Përmes tyre, ai njohu thellësisht mësimet e bektashizmit dhe trashëgoi një vizion të qartë për të ardhmen. Rrëfimi i jetës së tyre, sakrificat dhe mençuria, e bëjnë librin të ketë vlerë dokumentare e shpirtërore njëkohësisht.

Për këta dy klerikë të lartë, mendoj se rrëfimi, formimin dhe veprën e tyre, kohën në të cilën u shfaqën, e bën librin një vepër të admirueshme, më dokumentare dhe të lexueshme. Baba Mondit ka prekur madhështinë e dede Ahmetit, tek i cili ishin mishëruar shenjat e shenjtërisë së tij që në lindje të tij, thuhet se dede Ahmeti ra në gjunjë nga barku i nënës, ndërsa herë pas here ai parathotë mrekulli dhe fate njerëzore dhe kohësh. Baba Mondit, ka qenë partizan-antifashist gjatë Luftës së Dytë Botërore për çlirimin e vendit (madje ka pasur dy plumba në trup nga lufta), por edhe pse ishte një njeri me interesa të larta kulturore dhe intelektuale, ai nuk mësoi kurrë italisht, për shkakun se pushtuesit e vendit të tij ishin italianët. Ai ishte mjaft i lidhur me librat dhe leximin, duke i dhënë baba Mondit që në rininë e hershme kulturën e leximit të librave historikë dhe jetësorë.

Përballja me jetën dhe besimin, bektashizmi si udhë mistike dhe humanizëm

Një pjesë e rëndësishme e formimit të Baba Mondit ishte periudha e shkollimit në shkollën “Skënderbej” dhe në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve. Rregulli, disiplinimi, leximi i letërsisë klasike dhe moderne, puna dhe përlësia e forcuan karakterin e tij. Ky

Disiplina e armës dhe drita e shpirtit: Jeta dhe misioni i Kryegjyshit Botëror



formim iu bashkua trashëgimisë shpirtërore bektashiane dhe e bëri të aftë të përballonte kohë të vështira, siç ishte ndalimi i fesë në periudhën e diktaturës.

Megjithatë, besimi mbijetoi. Baba Mondit sjell me detaje kujtimet e mbledhjeve të fshehta familjare, festimet e ashures, këngët bektashiane, kujdesin për figurën e Imam Aliut dhe për traditën e të parëve. Përmes këtyre rrëfimeve kuptohet se feja nuk është thjesht një ritual, por një mënyrë jete dhe dashurie.

Në libër, Baba Mondit përsërit shpesh se “Bektashizmi është paqe”. Ai e sheh këtë besim si një urë lidhëse mes njerëzve, si një filozofi që tejkalon armiqtë dhe ndasitë, sepse merret me thelbin e njeriut. Ai përshkruan qartë tri shtyllat e bektashizmit: tarikatin (udhën mistike), marifetin (diturinë) dhe hakikatin (të vërtetën).

Një nga pjesët më të ndjera të librit është rrëfimi për Nënë Rajën, një grua e thjeshtë krutane që shkante çdo mbrëmje për të ndezur çirakët në Sari Salltik, duke sfiduar terrenin dhe kohën. Ky detaj i vogël, por i madh në domethënie, përmbledh sakrificën dhe përkushtimin e njeriut të thjeshtë ndaj besimit.

Udhëtimi drejt misionit të shenjtë

Figura e dede Reshatit është një tjetër shtyllë e librit. Baba Mondit e sheh atë si një dritë hyjnore-njerëzore, udhërrëfyes dhe shembull të sakrificës e humanizmit. Duke kaluar pranë këtyre figurave të mëdha, Baba Mondit u formua si njeri dhe si klerik, derisa arriti të bëhej Kryegjyshi i 39-të Botëror i Bektashinjve.

Baba Mondit në libër ka një përshkrim dhe meditim të rëndësishëm për udhërrëfyesin e tij drejt detyrës së

Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve, për dede Reshatin. Këtë, përveç se një klerik të lartë dhe të ditur, e sheh si një dritë të madhe hyjnore-njerëzore, të përkushtuar dhe human, komunikues e të sakrificës, dritë të dijes dhe të humanizmit në jetë.

Nisur nga rrugëtimi jetësor i Baba Mondit dhe i besimit bektashi, kupton dhe mëson njëherësh, në kolonat e personalitetit të tij, që janë: besimtar, njeri i iluminuar, intelektual dhe si një institucion i vendosur përballë kohës. Gjatë leximit të librit dhe të shpjegimit të thellë dhe të qartë kupton se ç’është bektashizmi, ç’janë normat mbi të cilat është përballuar dhe përcjellë në kohë, kupton thelbin e vetë besimit. Ai është për një integritet marrëdhëniesh të njerëzve në kohë, të cilat lidhen me kulturën, dijen, arsimin, doktrina të njohura të bektashizmit. Baba Mondit besimin dhe besimet i ka parë gjithmonë urë marrëdhënie në shoqëri, pasi siç thekson, besimet i kapërcejnë armiqtë e luftërave, sepse besimi merret me njeriun.

Në fund të librit, kujtesa shkon edhe tek vendet e shenjtë të bektashizmit: Ballëm Sulltani në Martanesh dhe Teqeja e Abaz Aliut në malin e Tomorit, vende pelegrinazhi që nuk mbeten vetëm për bektashinjtë, por janë hapur si ura bashkimi për të gjithë besimtarët.

Një libër me vlerë të veçantë

“Nefes” nuk është thjesht një autobiografi, por një dëshmi e gjallë e besimit, kulturës dhe historisë bektashiane në Shqipëri. Ai është një libër i përlur, pa asnjë shenjë urrejtjeje, edhe pse në të përshkruhen vuajtje dhe sakrificë. Mesazhi i tij kryesor është dashuria, paqja dhe besimi te njeriu.

Nëpërmjet këtij rrëfimi, lexuesi kupton se jeta e Baba Mondit është një jetë e ndërtuar mbi adhurimin për bektashizmin, mbi dashurinë për njerëzit dhe mbi përkushtimin ndaj misionit hyjnor. Ky libër është një nga kontributet më të rëndësishme të bektashizmit shqiptar në shoqërinë e sotme bashkëkohore.

Baba Mondit Në të gjithë librin dhe rrëfimin e jetës së tij, ruan një refleksion të thellë me familjen, vendlindjen, edukimin familjar, si një tregues bazik i formimit të tij. Gjatë gjithë librit autori thekson e vendos se nuk ka formim të shëndetshëm jashtë familjes, por gjithmonë brenda familjes, prandaj besimi bektashi ka arritur t’u mbijetojë dhe t’i përballojë turbulencat e kohës në të cilat është përballur në jetë.

Libri është shkruar me një gjuhë të thjeshtë dhe të pastër, që e bën më të kuptueshëm dhe të qartë misionin të cilin Baba Mondit ka hedhur mbi supet e tij. Libri është një histori e rëndësishme dhe e bektashizmit në Shqipëri, që vjen si dije, besim dhe mision hyjnor dhe shpirtëror për njerëzit. Libri vjen dhe si një doktrinë bektashizmi me norma dhe parime për dritën e madhe hyjnore, të përkushtimit, human, komunikues dhe të sakrificës.

Konferenca e Pezës, bashkimi që ndezi zjarrin e lirisë

Konferenca e Pezës, bashkimi i madh i popullit për çlirimin e Atdheut

Më 16 shtator 1942, në zemër të Pezës heroike, historia e Shqipërisë shkroi një nga faqet më të ndritura të saj. Në një kohë kur vendi gjendej nën pushtimin fashist italian dhe flamuri kombëtar ishte zëvendësuar nga simbolet e huaja, në Pezë u mbledhën përfaqësues të të gjitha shtresave shoqërore e politike shqiptare. Mesazhi ishte i qartë dhe i fuqishëm: Shqipëria do të luftojë e bashkuar për liri.

Pas 7 prillit 1939, Shqipëria jetonte nën një regjim shtypës. Por ndërsa pushtuesit mendonin se kishin thyer shpirtin e shqiptarëve, në çdo krahinë po rritej fryma e rezistencës. Çetat e para partizane kryen aksione kundër armikut dhe nevoja për një bashkim të madh kombëtar u bë jetike. Në këtë klimë, Myslym Peza priti në shtëpinë e tij delegatët që do të themelonin një organizim të përbashkët.

Në Konferencë morën pjesë personalitete të ndryshme: Enver Hoxha, Ymer Dishnica, Mustafa Gjinishi, Abaz Kupi, si dhe shumë figura patriotike nga zona e Pezës dhe më gjerë. Përtej dallimeve ideologjike, të gjithë u bashkuan në parimin se Atdheu ishte mbi çdo ndarje.

Vendimet historike

Konferenca e Pezës u kthye në aktin themeltar të rezistencës antifashiste. Vendimet e saj shënuan një kthesë të madhe në luftën për liri:

- U krijua Fronti Nacionalçlirimtar, si organi drejtues i luftës popullore.
- U shpall barazia e të gjithë patriotëve, pa dallim feje, krahine apo bindjeje politike.
- U hodhën themelet e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, që do të shndërrohej në forcën kryesore të çlirimit.

Ky bashkim i gjerë i dha luftës antifashiste karakter popullor dhe organizim të centralizuar, duke e kthyer në një kryengritje të armatosur kombëtare.

Pasojat dhe trashëgimia

Vendimet e Pezës i dhanë hov lëvizjes antifashiste, e cila brenda pak vitesh arriti kulmin me çlirimin e Shqipërisë, më 29 nëntor 1944. Edhe pse më vonë u shfaqën përçarje politike, Fronti Nacionalçlirimtar i dalë nga Peza mbeti bërthama e forcës çlirimtare. Konferenca e Pezës mbetet një gur kilometrik



i historisë sonë. Ajo dëshmon se vetëm përmes unitetit kombëtar mund të përballohen pushtuesit dhe të fitohet liria.

Aktivitete përkujtimore

Në 83-vjetorin e Konferencës, Peza u bë sërish qendër e kujtesës dhe e krenarisë kombëtare. Vizitorë nga i gjithë vendi, veteranë, studentë, familjarë e përfaqësues të institucioneve, morën pjesë në aktivitetet solemne e kulturore. Muzeu i Forcave të Armatosura ekspozoi armë dhe materiale historike që pasqyrojnë luftën antifashiste. Formacioni “Big Band” i Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura solli një

performancë të veçantë, duke ndërthurur mjeshtërisht muzikën ushtarake me elemente të pasura folklorike, në një interpretim që reflektoi energji, traditë dhe profesionalizëm.

U mbajtën fjalime patriotike, që rikujtuan rëndësinë e Pezës dhe apeluan për unitet edhe në kohët moderne.

Banorët e zonës dhe të ftuarit u bashkuan në një atmosferë festive, me flamuj, muzikë dhe një ndjenjë të fuqishme krenarie kombëtare. Konferenca e Pezës mbetet një shembull frymëzues i fuqisë së bashkimit. Mesazhi i saj është i qartë dhe aktual: “Kur populli bashkohet për atdheun, asnjë armik nuk mund ta mposhtë.”





KAPITEN (P) VERI TALUSHLLARI

Nga një udhëtim në Filadelfia, drejt një udhëtimi në traditë

Është gjithnjë kënaqësi të vizitosh Filadelfian. Rrugët e gjera e të pastra, historia e lavdia e qytetit ku u shpall Pavarësia dhe



Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara, sjellin ndërmend ngjashmëritë me Vlorën tonë, qytetin buzë detit ku u shpall Pavarësia e Shqipërisë. Madje, me humor, komuniteti shqiptar i ka dhënë qytetit një emër të dytë: “Filafieri”, pasi aty jetojnë shumë vlonjatë dhe fierakë.

Por kësaj here, udhëtimi ynë nuk kishte si destinacion vetëm bukuritë e qytetit, por një vend që ngroh shpirtin: “Oda Dibrane”.

Oda, institucion i shqiptarëve

Në traditën shqiptare, oda nuk është vetëm një hapësirë me katër mure e një oxhak. Ajo është simbol i burrërisë, mikpritjes dhe urtësisë. Aty mblidheshin burrat për të marrë vendime për familjen, fisin e krahinën, aty priteshin miq, zgjidheshin konflikte, lidhej besa dhe, në raste të veçanta, shpallehin edhe vendime lufte.

“Oda Dibrane” e ngritur në Filadelfia nga Major (L) Haki Çollaku, bir i një familjeje me tradita të Sllatinës së Dibrës, është mishërim i këtij institucioni. Ajo është njëkohësisht odë dhe muze, ku çdo objekt, pikturë e fotografi flet për historinë dhe kulturën shqiptare. Çiftelia, fyelli, veglat e punës, librat, portreti i Skënderbeut dhe kujtimet e brezave të familjes Çollaku e kthejnë këtë vend në një vatrë të gjallë shqiptarie.

Mirënjohje për ruajtjen e traditës

Pikërisht për këtë kontribut, Këshilli Bashkiak i Dibrës i ka dhënë Haki Çollakut një Certifikatë Mirënjohjeje me motivacionin: “Për kontributin e tij në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dibrane, përmes krijimit dhe mirëmbajtjes së Odës

“Oda Dibrane” në Filadelfia, një copëz Dibër në zemër të Amerikës



Dibrane në Filadelfia, një hapësirë autentike që mishëron mikpritjen, burrërinë dhe lidhjen shpirtërore me Atdheun”.

Vlerësimi është më se i merituar, sepse kush hyn në këtë odë, ndjen menjëherë shpirtin e traditës dhe krenarisë kombëtare.

Një familje në shërbim të Atdheut



Kapiten Hatixhe (Tixhi) Çollaku

NË TRADITËN SHQIPTARE, ODA NUK ËSHTË VETËM NJË HAPËSIRË ME KATËR MURE E NJË OXHAK. AJO ËSHTË SIMBOL I BURRËRISË, MIKPRITJES DHE URTËSISË. ATY MBLIDHESHIN BURRAT PËR TË MARRË VENDIME PËR FAMILJEN, FISIN E KRAHINËN, ATY PRITESHIN MIQ, ZGJIDHESHIN KONFLIKTE, LIDHEJ BESA DHE, NË RASTE TË VEÇANTA, SHPALLESHIN EDHE VENDIME LUFTE.

Traditat luftarake të derës së Çollakëve janë të hershme. Kulla e Taf Dautit në Sllatinë ka qenë bazë e Luftës Nacionalçlirimtare, por krisma e pushkës së kësaj dere është dëgjuar edhe më herët, kundër pushtuesve osmanë e serbë. Vetë Haki Çollaku ka shërbyer si oficer i Ushtrisë Shqiptare në kufi dhe në forcat speciale, ndërsa sot krenaria e tij është e bija, Kapiten Hatixhe (Tixhi) Çollaku, e diplomuar shkëlqyeshëm në Drexel University dhe tashmë oficerë në Ushtrinë Amerikane, me shërbime edhe në Shqipëri e Kosovë.

Një festë në shenjë nderimi

Për të nderuar këtë kontribut, Forumi i Ushtarakëve dhe miq të shumtë nga Shoqata “Bijtë e Shqipes” e Shoqata “Skënderbej” në Nju Jork, u mbledhën në një festë të bukur në vetë Odën e ngritur nga Haki Çollaku. Ish-kolegë, shokë e bashkëkombës vlerësuan punën dhe përkushtimin e tij, duke i dhënë edhe një tjetër Certifikatë Mirënjohjeje.

Një copëz Shqipëri përtej oqeanit

“Oda Dibrane” në Filadelfia nuk është thjesht një vend ku



mblidhen shqiptarët. Ajo është një urë shpirtërore me Atdheun, një kujtesë e gjallë se traditat nuk harrohen, kudo që të na hedhë fati.

Me përkushtimin e tij, Haki Çollaku ka arritur të sjellë një copëz Dibër, një copëz Shqipëri, në zemër të Amerikës dhe për këtë, meriton gjithë respektin dhe mirënjohjen e komunitetit.



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Ceremoniali në Akademinë e Sigurisë nuk mund të kuptohet i shkëputur nga tradita e ushtrisë shqiptare, e cila ka shërbyer si themel dhe inspirim në shumë aspekte të rregullave, protokolleve dhe riteve zyrtare. Ushtria, si institucioni më i hershëm i organizimit shtetëror, ka përcaktuar modelin e disiplinës, të uniformës, të betimit dhe të nderimit solemn ndaj flamurit e atdheut. Këto parime janë trashëguar e përshtatur në Policinë e Shtetit dhe veçanërisht në Akademinë e Sigurisë, ku ceremoniali nuk është vetëm formë e jashtme, por një mjet edukimi, krenarie dhe dinjiteti institucional. Në këtë mënyrë, ndërthurja e traditave ushtarake me ato policore krijon një vazhdimësi të natyrshme historike, duke e bërë ceremonialin jo thjesht një rregull protokollar, por një shprehje të identitetit dhe forcës së shtetit shqiptar.

Ritet e dinjitetit shtetëror, nga fushat e betejës tek auditorët e Akademisë së Sigurisë

Etërit arkeologë, historianë dhe etnografë, në vijueshmëri kanë hedhur dritë edhe mbi ceremonitë, rritet, veshjet, traditat, mikpritjen si disiplinë e “shpirt heroik”, mbi parimet, rregullat e ligjësitë, mbi rregullat praktike që fillimisht janë shkruar në kanune, sharte nga ligjvënësit popullorë në truallin ilirik, në Ballkan, Evropë e më gjerë. Prijësit, princat, mbretërit, sulltanët, liderët, gjeneralët që në lashtësi kanë krijuar ritet e para ceremoniale edhe në struktura policore e sidomos ato ushtarake krahas ceremonive që kanë ekzistuar edhe në aspektet e përgjithshme të jetës shoqërore, administrative si dhe besimtare. Që kur lindën “tributë”, fjalë pa tingëllim fisnikërues, që nuk shpreh si duhet kuptimin e “fisit” ose grup familjesh, shoqëria erdhi duke u zhvilluar dhe civilizuar. Kështu edhe strukturat ndërluftuese si dhe ato të ruajtjes dhe sigurisë së brendshme.

Romakët fiset i quanin “gens” dhe jurisprudenca e Kanunit themelohej mbi një kuptim moral krejt të veçantë, që sjell fisnikëri, krenari, dinjitet të personit si virtyte të vërteta. Në hapësirën arbërore, që në lashtësi dhe deri në ditët tona kanë vepruar kode e norma që kanë sjellë ceremoni e rite nga më të pasurat që njih sot njerëzimi, përtej kodeve të maleve shqiptare dhe përtej të “të drejtës Romake”. Ceremonitë ishin emblema e veprimtarive jetësore të popujve dhe të qytetërimeve tek romakët, helenët, egjiptianët, mesopotamasit, kinezët etj. Imazhet e civilizimeve nga lashtësia, që nga Platoni dhe papirusët e zbuluar dëshmojnë dhe hedhin dritë mbi prijësit, organizimet, betejat, ushtritë, ceremonitë ushtarake si gjurmë të vërtetësisë, sikurse vërehet edhe tek burimet mitologjike të Homerit nga vepra “Iliada” dhe “Odisea”. Në periudha të ndryshme është pretenduar edhe për ceremonial që shkonin deri në “pavdekësi të përgjeshme” etj. Përtej civilizimeve të planetit tonë, në hapësirën ilirike kanë vepruar bindshëm mbretërit e princat ilirikë dhe arbërorët mesjetarë, që në periudhën Skënderbejane ceremonitë u ngritën në art sikurse mbretëritë e sulltanatet më të shquara të Evropës. Kështu një ndër ceremonitë që ka lënë gjurmë të fuqishme ka qenë ceremonia e martesës së heroit të shqiptarëve Gjergj Kastriotit 46 vjeçar me Donikën 23 vjeçare, të bijën e Gjergj Arianitit, më 23 prill 1451, një ceremonial popullor, tradicional

Ceremoniali si shtyllë e dinjitetit shtetëror: nga Ushtria Shqiptare tek Akademia e Sigurisë



dhe ushtarak zhvilluar në Kaninë, në Ardenicë dhe në Krujë me prezencën edhe të ambasadorëve të Napolit, të Vatikanit dhe Raguzës. Nuk ka qenë një ceremonial martesor, por me rregulla juridike dhe tradicionale, ku përveç rëndësisë shoqërore, martesat lidhën familjet fisnike në aleanca, koalicionet dhe marrëdhënie të shumëfishta, ku mosha, intelekt, formimi kulturor, gjendja shëndetësore, paraqitja e jashtme nuk kishin rëndësi për bashkëshortët e ardhshëm. Funkcioni i parë i lidhjeve ishte ai politik, i cili do të forconte pozitën e familjeve, fiseve, principatave. Ceremoniali ishte “qershia mbi tortë”, që sillte ushtri të përbashkuara, tokat, prodhimet, taksat, rrugëkalimet e sigurta në dispozicion të qëllimeve. Ceremonitë çonin në organizime me unitet të faktorëve ushtarak e politik dhe deri tek ceremonitë mortore, veçanërisht për ato ceremoniale që kishin të bënin me të rënë për atdheun dhe me betimin në kauzën e tyre. Padyshim në lëmin e ceremonialeve të ushtrive të popujve, kombeve e shteteve të botës “pjesën e luanit” e zënë ceremonitë që determinojnë tre shekujt e fundit, ku paradat në lindje e në perëndim me forca e mjete tokësore, detare e ajrore kapërcejnë sot çdo lloj limiti të njohur në sasi mjeteshe e forcë njerëzore, ku shpenzimet ushtarake për këtë qëllim shkojnë në shifra të marramendëse. Ceremoni të tilla veçanërisht në periudhën e luftës së ftohtë ishin një demonstrim i hapur force, për të treguar “krenari”, demonstrim force dhe “fuqi shtetërore” në tokë, në det dhe në ajër. Në aspektet e zhvillimeve policore policia e lashtë në Egjipt, rreth 2500 vjet më parë, kishte roje të organizuara që mbronin rendin dhe tempujt, në Athinë ka pasur roje skllavër, në Romën e lashtë ishin Cohorta urbane për të mbërritur në “policinë moderne” si institucion civil shtetëror i ndarë nga ushtria më 1829, kur u krijua “Policia Metropolitane” e Robert Peel-it. Më tej edhe francezët dhe përhapja në gjithë botën. Në Shqipëri krijimi i

Policisë Shqiptare daton më 13 janarin e 1913-ës dhe është binjak me krijimin e shtetit. Ceremonialet kanë filluar më vonë por pas kursit të parë policor shqiptar të 21 majit 1938, viti 1945 shënoi një hap të ri e më tej 20.1.1954, por Akademia e Policisë si IAL daton më 20.12.1971, kur edhe ceremonitë janë zhvilluar në truallin tradicional të përgatitjes së ardhmërisë policore në të gjitha nivelet në Sauk, që edhe pse ka ndërruar disa herë emërtimin, por jo misionin, konsoliduar në dhjetëvjeçarin e fundit (2015-2025) me emërtimin zyrtar “Akademia e Sigurisë”.

“Kartëvizita” e krenarisë dhe dinjitetit në edukimin policor

Praktika dokumentare e ceremonive në Akademinë e Sigurisë është duke u konceptuar si një dokument administrativ teoriko-praktik që përcakton rregulla teknike, protokollare, etike, profesionale, funksionale të pranueshme të mbështetura në legjislacion, në aktet dokumentare të mirëfunksionimit institucional bazuar në aktet ligjore, nënligjore dhe administrative. Zhvillimi i Ceremonive në Akademinë e Sigurisë është vijueshmëri logjike dhe kronologjike e “Rregullores së Ceremonialit në Republikën e Shqipërisë”, por edhe e “Procedurave dhe rregullave për zhvillimin e ceremonive, bisedimeve, takimeve dhe vizitave zyrtare në Policinë e Shtetit”, të miratuar me urdhër të DPPSH (nr. 208 datë 21.02.2019), por edhe veçoritë dhe karakteristikat që lidhen me misionin dhe funksionin e Akademisë së Sigurisë në veprimtaritë ceremoniale të ndryshme që zhvillohen brenda vetë misionit të Akademisë së Sigurisë.

Në radhë hierarkike Akademia e Sigurisë nderon dhe respekton rregullat e ceremonialit shtetëror, të Ministrisë së Brendshme dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Ceremoniali policor është një instrument juridiko-administrativ nëpërmjet

të cilit strukturat kompetente të AS-së urdhërdhënëse ushtrojnë veprimtarinë protokollare mbi bazën e legjislacionit dhe në përputhje me të, në funksion të realizimit të detyrimeve kushtetuese, akteve ligjore e nënligjore, për kryerjen e një sërë aktiviteteve që lidhen me nderimet, respektimin, ngritjen e moralit të kursantëve/studentëve të FSH-së, me ceremoni zyrtare të diplomimit/ certifikimit, me ceremoni të vendosjes së kurorave me lule në varrezat e dëshmorëve të Atdheut, me ceremoni të paradave dhe betimit, me marrje e dorëzim të flamujve, me ceremoni dekorimesh dhe gradimesh, ceremoni pritjesh e përcjelljesh, me ceremonitë në Akademinë e Sigurisë ose jashtë saj, me nderime në ditë festash kombëtare ose të miqve e partnerëve tanë, me ceremoni për nderim dëshmorësh të rënë në krye të detyrës, ceremonitë e pritjes së personaliteteve në Konferencat Shkencore të AS-së, me ceremonitë e prezantimit në detyrë, ceremonitë e daljes në pension të punonjësve të policisë të AS-së, me ceremonitë specifike në strukturat e vartësisë së Akademisë së Sigurisë, ceremoni të përcjelljes në banesën e fundit ose “ceremonia e apelit të fundit”, si dhe ceremoni të veçanta të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, etj. Objekti i ceremonialit në AS është që të përcaktojë qartësisht rregulla të përcaktuara të formatit konkret të veprimit teknik, mendimit e veprimit policor të kornizuar për organizimin e ceremonive të të gjitha llojeve, në formulimin e rregullave strikte etike-profesionale të punonjësit të Policisë së Shtetit, vlerësimi i rolit dhe funksionit të tyre. Ceremonitë e policisë janë paraqitje dinjitoze të të gjithë spektrit policor, duke paraqitur në këtë rregullore përcaktime të gjithë-pranuara nga opiniononi shoqëror për ceremonitë policore në sinkron të plotë edhe me ceremonitë e partnerëve të policive të vendeve aleatë e partnerë, por mbi të gjitha do të spikasë identiteti kombëtar shqiptar dhe i strukturës që përfaqëson.

Koncepti ceremonial policor nuk është “pronë” vetëm e strukturave civilo-policore ose të marrëdhënieve me publikun, por i përket drejtuesve të Akademisë së Sigurisë, strukturave të vartësisë në të gjithë piramidën e funksionimit të një paraqitje dinjitoze dhe krenare në planin e brendshëm por edhe në planin e bashkëpunimit ndër-rajonal dhe ndërkombëtar, në misione ose në komanda e shtabe të vendeve mike, aleatë e partnerë, ku ka pjesëmarrje edhe nga institucioni i Akademisë së Sigurisë. Veprimtaritë ceremoniale në Akademinë e Sigurisë duhet të kenë rregullat e tyre plotësisht të qartësuara me qëllim që të mos ngatërrohet me një nderim të thjeshtë ose “për mirësjellje”, “për njerëzillëk” etj., por opiniononi i përgjithshëm, komuniteti civil dhe policor, dhe mbi të gjitha media e shkruar dhe ajo elektronike të jetë plotësisht e informuar mbi mënyrat dhe rregullat që veprojnë prerazi në strukturat policore. Çdo lloj veprimtarie ceremoniale që kryhet në AS ka gjithmonë një skenar të gatshëm të qartësuar në këtë rregullore.

Në dokumentacionin standard të ceremonialit mund e duhet të gjenden skenarë të gatshëm, të thjeshtë, të pritshëm dhe të zbatueshëm, të njohur nga komuniteti i madh e i vogël, pavarësisht kulturës, nivelit të arsimimit, përkatësisë së besimeve. Në rregullore përcaktohet qartë se mirësjellja është detyrim që përputhet me nivelin e zhvillimit kulturor si dhe i përket individit në shoqëri; ndërkohë që kjo rregullore synon bindjen në atë që, rregullat ceremoniale janë tërësia e rregullave që dispijlojnë paraqitjen formale të enteve, të titullarëve e të detyrave e funksioneve që ata përfaqësojnë. Rregullorja e ceremonialit në Akademinë e Sigurisë, para së gjithash nënkupton një sinkron rregullash të shkruara e të përcaktuara qartë në kohë dhe të përputhura në mendim, në traditë e në zakone shqiptare, që bashkon në një të vetme prezencën fizike, pamjen e uniformizuar, veprime të sinkronizuara dhe mirësjellje njerëzore, që të imponojë respekt dhe lë gjurmë të thella formuese, imponuese, memorizuese dhe që kryhet në kohë e hapësirë.

Zhvillimi i ceremonive në Akademinë e Sigurisë përfaqëson përmbledhjen institucionale të kriterëve që rregullojnë çdo aspekt të natyrës formale dhe joformale dhe në sinkron të plotë me të gjitha rregulloret e aplikueshme të jetës së brendshme, të rregullores në rreshtime policore, të disiplinës, të uniformës, të armëve të ndryshme, që shërbejnë si pjesë e Policisë së Shtetit në të gjithë komponentët e saj, si dhe në strukturat e tjera mbështetëse, në arsimim stërvitje e trajnim. Rregullorja e ceremonialit përmbledh në mënyrë të detajuar dhe të specifikuar gjithë parimet e rregullat objektivisht të gjithë-pranuara që rregullojnë e sanksionojnë në mënyrë të përbashkuar format e marrëdhënieve ndër-njerëzore, si dhe ndërmjet strukturave, e deri tek individët në Akademinë e Sigurisë, për të formësuar norma e rregulla të përcaktuara qartë, pa kontraste, dhe që lehtësojnë raportet ndërmjet subjekteve në jetën e veprimtarinë policore, të jetesës në komunitet etj. Rregullat e ceremonialit ushtarak bëjnë njëjshimin e një rregulli, një metode, një gjuhe të njëjshuar, një kodi me sjelljeje, qëndrim, formë, të përbashkuar e të përshtatshëm, për të komunikuar në mënyrë korrekte, për të patur mendim e qëndrim unifikues edhe në kuadrin e shoqërizimit policor e civil në Policinë e Shtetit, por edhe ndaj qëndrimit institucional që duhet të mbajnë punonjësit e policisë e civilët që shërbejnë në strukturat e Akademisë së Sigurisë. Kodi i shprehjes, qëndrimit dhe veprimit do të jetë i unifikuar që rrjedh nga zbatueshmëria e misionit dhe detyrimeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, duke e parë në tërësi dhe në unitet detyrimin ligjor, detyrimin shoqëror dhe detyrimin institucional, duke synuar që çdo veprim, qëndrim apo shprehje të jetë një pasurim i mëtejshëm i vlerave në Akademinë e Sigurisë.

Protokoll është emërtimi etimologjik, që rrjedh nga “protokoll”, që tregon faqen e parë të një kodi ose dokumenti (“proto” që do të thotë “i parë” dhe “kollo” që do të thotë “ngjithës”). Kuptimi i saj vazhdon më tej për të treguar përmbajtjen e vetë dokumentit. Kuptimi i protokollit është tërësia e normave që rregullojnë ceremonialin, duke iu referuar aspekteve publike dhe praktikës që ndiqet, sipas rregullave të vendosura nga struktura eprorë me të drejta ekzekutive.

Konkretizimi me dokument themelor të ceremonialeve në Akademinë e Sigurisë janë vijimësi dhe përmirësim i mëtejshëm i veprimtarive institucionale në institucionit e edukimit policor, duke njohur zhvillimet e deritanishme dhe duke parë në sy kritik ardhmërinë e zhvillimeve arsimore policore. Prandaj sfida e së ardhmes është një sfidë komplekse jo vetëm në fushën e ceremonialit dhe Protokollit, por edhe më gjerë. Në aspektet praktike protokollit mund të jetë ceremonial, diplomatik, policor apo i fushave të tjera. Ai është i përcaktuar si rregulli i marrëdhënieve zyrtare publike, por sipas rastit ka elemente njerëzorë, por jo liberalë. Normat e protokollit kanë jo vetëm vlerë të brendshme, por dhe zyrtare, duke rregulluar aspektet formale të marrëdhënieve ndërmjet strukturave, enteve e organeve të ndryshme në AS dhe më gjerë. Përvoja dhe tradita shqiptare, por edhe ajo e vendeve partnere ka treguar se nuk mund të ketë ceremonial pa disiplinë dhe pa rregull. Prandaj ceremoniali fillon tek rregullat e shkruara e të precizuara qartë dhe përfundon me mbylljen e aktivitetit korrekt sipas skenarëve të paracaktuar. Disiplina protokollare përmban në vetvete kornizën e kriterëve në zgjidhjen e problematikës formale, duke detajuar çdo moment të rëndësishëm apo dytësor në marrëdhëniet publike zyrtare.

Teorizimet “doktrino”, në çështjet e ceremonialit dhe protokollit si dhe dalja jashtë sistemit disiplinor protokollar është e palejueshme dhe e pa tolerueshme. Kështu protokollit ka rregullat e veta specifike që ushqejnë autonominë nga disiplinat juridike dhe sociale, edhe pse protokollit merr elementë të formalizimit nga këto disiplina bazë. Organizatorët e ceremonive në Akademinë e Sigurisë si dhe të protokollit mbajnë në konsideratë edhe normat

dhe rregullat ndërkombëtare që dispijlojnë ceremonialin, përfshi edhe traditat kombëtare të zhvillimeve policore nga 13 janari i vitit 1913, kur u krijua Policia e Shtetit e në vijueshmëri. Ceremoniali në Akademinë e Sigurisë dhe jo vetëm është i natyrës më solemne dhe kjo natyrë buron nga misioni e përgjegjësitë të cilat e kanë burimin nga rregulloret e DPPSH-së dhe të AS-së.

Në planin historik duhet theksuar, se ceremoniali ka ekzistuar para krijimit të shtetit që në kohën që shoqëria ishte organizuar me fise e tribu dhe ka pasuar në të gjitha etapat e zhvillimit shoqëror të shoqërisë. Rregullat e ceremonialit janë formuar në shekuj dhe kanë origjina nga më të ndryshmet që mund të lidhen me arsye praktike, të higjienës; me arsye estetike; me arsye mistike, kohore; praktike; politike; shoqërore; ambientale; ekonomike; morale; komunikimi dhe tregtare-komerciale etj., që janë një larmi kohësh e traditash, por në kohët moderne edhe në spektrin e policimit dhe sidomos të arsimimit policor marrin një vlerë të re dhe të spikatur. Ceremonitë, rregullat dhe protokollit ekzistojnë në të gjitha fushat e jetës, por nisur nga pikëpamja e fushës që ato zënë ndahen në: shtetërore, diplomatike policore, etj., kategori këto që kanë lidhje të shumta e të shumëfishta me njëra-tjetrën. Në rregulloren e ceremonialit do të përfshihen nenet e domosdoshme dhe shtojcat të cilat do ta lehtësojnë përdorimin e kësaj rregulloreje. Ajo duhet të jetë në sinkron me aspektet shpjeguese dhe vepruese ekzekutive, ku protokollit i ceremonive policore do të jetë i detajuar me të gjithë elementët dhe veçoritë përbërëse, që burojnë nga karakteristikat e veçanta të Akademisë së Sigurisë dhe rregulloret që përcaktojnë dhe rregullojnë aktivitetin dhe veprimtarinë në spektrin e veprimit mësimor, edukativ dhe kërkimor shkencor. Në rregulloren e ceremonialit strukturat e arsimimit dhe kurrikulave do të gjejnë një “lëndë të gatshme”, për ta përdorur në “stërvitjet ceremoniale” si dhe “rregulla të jetës sociale të ardhmërisë së Policisë së Shtetit”. Është e natyrshme se Rregullorja e ceremonialit do të përfshijë masivisht jetën policore të kursantëve dhe të studentëve, por që ka brenda dhe presupozon elementë të shumtë patriotikë, moralë, psikologjikë, estetikë e profesionalë, detyrimisht dhe këto elementë gjejnë veten në protokollin e ceremonialin e AS-së duke synuar përfaqësim në nivel sa më të lartë e të qëndrueshëm. Ceremoniali në AS mund të jetë me uniformë, dekorata, flamurin, stemën, shenjat dalluese, dekoracionet, emblemat, uniformat e flamujt e strukturave që veprojnë në Policinë e Shtetit, kur është e lejueshme edhe shenjat emblemë të traditës kombëtare si kostumet ceremoniale si dhe mjaft elementë të tjerë, që shërbejnë si mjet shprehës i komunikimit me publikun vetëm me dukshmërinë e tyre. Natyrisht emblema e ceremonialeve në Policinë e Shtetit janë flamuri kombëtar, flamuri i Policisë së Shtetit, flamuri i Akademisë së Sigurisë si dhe uniforma që etiketohet “ceremoniale”.

Rregullorja e Ceremonialit në Akademinë e Sigurisë është një përmbledhje aktesh institucionale të unifikuar e standardizuar, në përputhje me historinë, kulturën, trashëgiminë, nevojat dhe kushtet e reja, për t’iu përgjigjur kërkesave e detyrimeve si dhe pritshmërinë e publikut për policinë. Gjithë sistemi i profesionalizmit policor, mirë-arsimimit, mirë-trajnit, rritjes së kapaciteteve, në interes të realizimit të misionit, kontributit në zgjidhjet e çështjeve të rendit dhe sigurisë publike, mbështetet cilësisht me parime, rregulla e praktika të zhvillimit të ceremonive policore sikurse edhe vendet mike e partnere të Shqipërisë. Krijimi i një standardi për vendosjen e rregullave strikte të mirëfunksionimit në të gjitha llojet e ceremonive të shkruara teorikisht dhe të sjella edhe me shembuj praktikë mbi mënyrën e veprimit për të gjitha rastet e ceremonive që zhvillohen në Institucion të Arsimit të Lartë në fushën e rendit dhe sigurisë publike në Shqipëri sjell në mënyrë definitive atë që quhet kartëvizitë e dinjitetit dhe krenarisë së strukturave policore shqiptare.

Ushtria e Shteteve të Bashkuara, e parë shpesh si një simbol i fuqisë dhe precizitetit, ka vepruar prej kohësh pas një veli sekreti. Ndërsa shumë nga misionet e saj të fshehta justifikohen nga siguria kombëtare, historia ka treguar se disa operacione kanë kaluar kufijtë etikë, kanë shkaktuar polemika globale dhe kanë ushqyer breza të tërë teorish konspiracioni. Ky ekspozim zbulon shtresat e fshehura të operacioneve të klasifikuara ushtarake të SHBA-së - disa të konfirmuara, të tjera të pëshpëritura në hije.



Zona 51: Epiqendra e Dijes Aliene

E vendosur në shkretëtirën e Nevadës, Zona 51 është bërë sinonim i spekulimeve jashtëtokësore. Fillimisht një terren testimi për aeroplanë spiunë në lartësi të madhe si U-2 dhe SR-71 Blackbird, ekzistenca e saj u mohua për dekada. Sekretet që rrethonte qëllimin e saj, i kombinuar me incidentin famëkeq të Roswell, dha shkas për teoritë e autopsive të alienëve dhe anijeve kozmike të projektuara me inxhinieri të kundërt. Ndërsa dokumentet e deklasifikuara konfirmojnë testimin e aviacionit, narrativa e alienëve mbetet një fenomen kulturor.



Vendi i Provës në Dugway: Hijet Kimike

I vendosur në Utah, Dugway është një strukturë e gjerë testimi për armë kimike dhe biologjike. Në vitin 1968, një incident misterioz la mijëra dele të ngordhura, gjoja për shkak të ekspozimit ndaj agjentëve nervorë. Megjithatë ushtria mohoi fajësinë, ngjarja ngriti alarme në lidhje me rreziqet e eksperimenteve të tilla. Dugway vazhdon të veprojë, i mbështjellë nga siguria e rreptë dhe shqetësimi publik.

MK-Ultra: Makthi i Kontrollit të Mendjes

Një nga programet më të frikshme të zbuluara ndonjëherë, MK-Ultra ishte një iniciativë e udhëhequr nga CIA gjatë Luftës së Ftohtë që synonte zhvillimin e teknikave të kontrollit të mendjes. Përmes përdorimit të LSD, hipnozës dhe torturës psikologjike - shpesh mbi subjekte të pavetëdijshme - programi kërkonte të manipulonte sjelljen. I deklasifikuar në vitet 1970, MK-Ultra ekspozoi një kapitull të errët eksperimentimi që shkelte të drejtat e njeriut dhe kufijtë etikë.



Nën Sipërfaqe: Një Eksplorim i Gjatë i Sekreteve Ushtarake të SHBA-së

Zbulohen operacionet e klasifikuara ushtarake amerikane

Incidenti i USS Liberty: Zjarr Miqësor apo Mbulim?

Në vitin 1967, gjatë Luftës Gjashtëditore, forcat izraelite sulmuan anijen USS Liberty, një anije intelligence e Marinës Amerikane. Shpjegimi zyrtar ishte identiteti i gabuar, por të mbijetuarit dhe kritikët argumentojnë se ishte një akt i qëllimshëm. Incidenti mbetet një nga më të debatuarit në historinë ushtarake, me pyetje të vazhdueshme rreth motivit dhe përgjegjësisë.

Pine Gap: Sytë në Qiell

Një bazë e përbashkët mbikëqyrjeje SHBA-Australi pranë Alice Springs, Pine Gap luan një rol vendimtar në mbledhjen globale të inteligjencës. Ai gjurmon satelitët, kap komunikimet dhe mbështet operacionet me dronë. Vendndodhja e tij e largët dhe qasja e kufizuar e kanë bërë atë një magnet për spekulime, duke përfshirë teoritë rreth bunkerëve nëntokësorë dhe aftësive bërthamore.

Operacioni Paperclip: Shkenca nga Hiri

Pas Luftës së Dytë Botërore, SHBA-të rekrutuan fshehurazi mbi 1,500 shkencëtarë nazistë, përfshirë Wernher von Braun, për të forcuar avantazhin e tyre teknologjik. Ndërsa programi përshpejtoi përparimet në lëmin e raketave dhe eksplorimin e hapësirës, ai gjithashtu ngriti pyetje morale në lidhje me punësimin e individëve të lidhur me krime lufte. Operacioni Paperclip mbetet një shembull i diskutueshëm i pragmatizmit mbi parimin.

Projekti Manhattan: Lindja e Bombës

Gara për të zhvilluar armë bërthamore gjatë Luftës së Dytë Botërore çoi në krijimin e Projektit Manhattan - një operacion masiv, me shumë vende që përfshinte mijëra shkencëtarë. Suksesi i tij kulmoi me bombardimet e Hiroshima dhe Nagasaki, duke ndryshuar përgjithmonë luftën globale. Fshtetësia e projektit ishte e pakrahueshme dhe trashëgimia e tij vazhdon të formësojë politikën bërthamore.

HAARP: Shkencë apo Magji?

Programi i Kërkimit Auroral me Frekuencë të Lartë Aktive (HAARP) në Alaska u krijua për të studiuar jonosferën për qëllime komunikimi dhe mbikëqyrjeje. Megjithatë, aftësitë e tij janë ekzagjeruar shumë nga teoricienët e konspiracionit, të cilët pretendojnë se mund të manipulojë motin, të shkaktojë tërmete ose të kontrollojë mendjet. Shkencëtarët i hedhin poshtë këto pretendime, por mistika vazhdon.

Kompleksi Malor Cheyenne: Fortesa e Mbrojtjes

E varrosur thellë brenda një mali graniti në Kolorado, kjo qendër komande NORAD u ndërtua për t'i bërë ballë sulmit bërthamor. Ajo monitoron kërcënimet hapësinore dhe shërben si

një qendër strategjike për operacionet mbrojtëse. I popullarizuar në filma dhe TV, Mali Cheyenne simbolizon paranojën e Luftës së Ftohtë dhe nevojën e vazhdueshme për infrastrukturë të sigurt komande.

Projekti Libri Blu: UFO-t në shqyrtim

Nga viti 1952 deri në vitin 1969, Forcat Ajrore Amerikane hetuan mijëra pamje të UFO-ve në kuadër të Projektit Libri Blu. Ndërsa shumica u shpjeguan si fenomene natyrore ose avionë, një përqindje e vogël mbeti e pashpjeguar. Mbyllja e projektit bëri pak për të shuar magjepsjen publike dhe hodhi themelet për përpjekjet moderne të kërkimit dhe zbulimit të UFO-ve.

Këto operacione, objekte dhe programe përfaqësojnë një tapet kompleks ambiciesh, sekretit dhe polemikash. Disa lindën nga domosdoshmëria e kohës së luftës, të tjera nga paranoja e Luftës së Ftohtë dhe disa mbeten enigmatike deri më sot. Qofshin të konfirmuara apo spekulative, ato vazhdojnë të formësojnë perceptimin publik për ushtrinë amerikane dhe shtrirjen e saj në të panjohurën.



Pesëdhjetë vjet pas uljes në Hënë: Pse eksplorimi hapësinor sapo ka filluar

Më shumë se gjysmë shekulli më parë, njerëzimi bëri hapat e parë në Hënë - një moment aq i thellë sa dukej se premtonte një të ardhme me qytete hënore, udhëtime ndërplanetare dhe zbulime kozmike. Megjithatë, ndërsa pluhuri u ul mbi çizmet e Neil Armstrong dhe programi “Apollo” u përfundua, ëndrra e udhëtimit rutinë hapësinor u zbeh në sfond. Për dekada, kritikët u ankuan për mungesën e misioneve pasuese, duke pyetur veten nëse epoka e artë e eksplorimit të hapësirës kishte kaluar.

Por ky rrëfim është i vjetëruar. Eksplorimi i hapësirës nuk është ngadalësuar - ai ka evoluar. Dhe sot, po lëviz më shpejt, më gjerë dhe më thellë se kurrë më parë.

Nga flamujt në funksion, ndryshimi në prioritetet hapësinore

Misionet “Apollo” u nxitën nga urgjenca e Luftës së Ftohtë - një garë për të provuar superioritetin teknologjik. Pasi u fitua kjo garë, SHBA-të u kthyen drejt përpjekjeve më të qëndrueshme dhe të pasura shkencërisht. Ndërtimi i Stacionit Ndërkombëtar Hapësinor (ISS) shënoi një pikë kthese: nga gjestet simbolike në banimin dhe kërkimin afatgjatë.

Që nga viti 2000, ISS ka pritur astronautë nga e gjithë bota, duke kryer eksperimente që kanë riformësuar mjekësinë, shkencën e materialeve dhe kuptimin tonë të biologjisë njerëzore në mikrogravitet. Nuk është një shëtitje e shndritshme në hënë, por është një punë themelore - duke hedhur themelet për misione më të thella hapësinore.

Revolucioni i qetë, përparime shkencore përtej vëmendjes

Ndërsa këmbët njerëzore nuk e kanë prekur Hënë që nga viti 1972, eksploruesit robotikë kanë qenë të zënë. Roverët e Marsit si “Curiosity” dhe “Perseverance” kanë hartuar terrene të huaja, kanë shpuar në shkëmbinj marsianë dhe kanë kërkuar shenja të jetës së lashtë. Sondat “Voyager”, të nisura në vitet 1970, tani po dërgojnë të dhëna nga hapësira ndëryjore - përtej mundësive të sistemit tonë diellor.

Ndërkohë, teleskopët si “Hubble” dhe teleskopi hapësinor “James Webb”, kanë parë në origjinën e universit, duke zbuluar galaktika miliarda vjeçare dhe duke kapur imazhet e para direkte të ekzoplanetëve. Këto zbulime nuk janë vetëm akademike - ato janë ekzistenciale. Ato sfidojnë vendin tonë në kozmos dhe aludojnë për mundësinë e jetës përtej Tokës.

Hapësira në jetën tonë të përditshme

Hapësira nuk ka të bëjë vetëm me planetë të largët - është e ndërthurur në ekzistencën tonë të përditshme. Navigimi GPS, komunikimet satelitore, parashikimi i motit dhe monitorimi i klimës mbështeten të gjitha në infrastrukturën e bazuar në hapësirë. Satelitët e vëzhgimit të Tokës gjurmojnë shpyllëzimin, monitorojnë zjarret në pyje dhe ndihmojnë në parashikimin e fatkeqësive natyrore. Shkurt, teknologjia hapësinore po shpëton në heshtje jetë dhe po formëson politikat.

Gara e re hapësinore: Sektori privat merr drejtimin

Një nga ndryshimet më dramatike në vitet e fundit është rritja e fluturimeve komerciale hapësinore. Kompani si “SpaceX”, “Blue Origin” dhe “Rocket Lab” kanë transformuar ekonominë e hapësirës. Raketat e ripërdorshme, dikur një fantazi, tani janë rutinë. “Falcon 9” i “SpaceX” ka ulur kostot e lëshimit dhe i ka bërë misionet orbitale më të arritshme se kurrë.

Këto kompani nuk po lëshojnë vetëm satelitë - ato po planifikojnë ulje në Hënë, misione në Mars dhe madje edhe turizëm hapësinor. Kufiri midis qeverisë dhe ndërmarrjes private



po zbehet, dhe rezultati është një rilindje e inovacionit.

Kthim në Hënë dhe Përtej

Programi “Artemis” i NASA-s synon të kthejë njerëzit në Hënë deri në mesin e viteve 2020, duke përfshirë gruan dhe personin e parë me ngjyrë që do të ecë në sipërfaqen e saj. Por kjo nuk është vetëm një përsëritje e “Apollo-s”, është një trampolinë. Hëna do të shërbejë si një terren testimi për teknologjitë e nevojshme për të arritur në Mars dhe më gjerë.

Planet për stacionin hënor “Gateway”, një stacion i vogël hapësinor që rrotullohet rreth Hënë, do të ofrojë një platformë nisjeje për misione më të thella. Ndërkohë, partnerët ndërkombëtarë dhe kompanitë private po kontribuojnë me anije uljeje, roverë dhe infrastrukturë. Është një përpjekje globale dhe po fiton vull.

Sytë në horizont

Duke parë përpara, mundësitë janë marramendëse. Misionet në Evropë dhe “Enceladus” synojnë të eksplorojnë oqeanet nëntokësore që mund të strehojnë jetë. Miniera e asteroideve mund të zhbloktojë burime të reja. Dhe misionet njerëzore në Mars, dikur fantastiko-shkencor, tani po planifikohen në mënyrë aktive.

Turizmi hapësinor është tashmë në zhvillim e sipër, me

fluturime suborbitale që u ofrojnë civilëve një pamje të Tokës nga lart. Ndërsa teknologjia përparon, pushimet orbitale dhe ekskursionet hënore mund të bëhen realitet për ata që kanë mjetet - dhe përfundimisht, për masat.

Udhëtimi sapo ka filluar

Ulja në Hënë ishte një triumf i zgjuarsisë njerëzore, por nuk ishte menduar kurrë të ishte destinacioni përfundimtar. Ishte një shkëndijë - duke ndezur dekada inovacioni, kurioziteti dhe progresi të qetë. Sot, eksplorimi i hapësirës nuk kufizohet më vetëm në laboratorët qeveritarë ose në platformat e largëta të lëshimit. Është një përpjekje e përbashkët, e nxitur nga bashkëpunimi global, ambicia private dhe një ndjenjë e ripërtërirë qëllimi.

Ne qëndrojmë në prag të një epoke të re - ku Hëna është një portë hyrëse, Marsi është i arritshëm dhe kërkimi për jetë përtej Tokës nuk është më temë fantastiko-shkencore. Udhëtimi përpara nuk do të shënohet nga momente të veçanta, por nga një vrull i qëndrueshëm. Dhe ndërsa shtyjmë më tej në kozmos, nuk po eksplorojmë vetëm hapësirën - po ripërcaktojmë se çfarë do të thotë të jesh eksplorues.

Mund të mos jemi duke bërë udhëtime fundjave në Hënë ende, por mos e ngatërroni këtë me ngecje. Motorët e zbulimit po gjëmojnë - dhe yjet janë më afër se kurrë më parë.



ATDHEU NDERI DETYRA